

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

ECOMMASSIST

Sot, më date 22.02.2025, personalisht:

Domenico Luise, atesia Mauro, shtetas Italian, lindur me 14.08.1990, ne Sapri, Itali dhe banues ne Via Francesco Laino, Nr.14, Sapri, Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me karte identiteti, me cilesine e ortakut themelues te shoqerise tregtare.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare me termat e mëposhtme;

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me:

Emri i Shoqerise: ECOMMASSIST

Emri tregtar: ECOMMASSIST

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Keshillim dhe asistence mbi menaxhimin, planifikimin strategjik dhe organizues, objektivat dhe politikat e marketingut duke përfshirë por pa u kufizuar në menaxhimin dhe promovimin e imazhit dixhital.
- Bërjen e fushatave publicitare dhe të tjera shërbime reklamuese me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e klientëve dhe promocioni i produkteve.
- Studimi i tregut dhe sondazhet.



NENI 4 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Myrtezim Kellici, Pall Al-Fam, Nr.23 Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 5 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është 100.000 (njqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortakut themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakut i vetem themelues.

NENI 6

Ortakut themelues i Shoqërisë Tregtare zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Domenico Luise, pjesëmarrja me përqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 100.000 leke.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakut i vetem themelues.

NENI 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortakut i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë të shoqërisë do të jenë Z. Domenico Luise

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 9

Ortakut mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 11

Mosmarrvëshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 12

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe pasi ortaku është njohës i gjuhës shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Domenico Luise

Domenico Luise

P.d.